

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr. 03/l-079, për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut, nr. 2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, Kolegji i përbërë prej gjyqtarëve Ragip Namani, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Jelena Krivokapić, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike të **Palës ankuese** :

N. Dj., Ul. "...Republika e Serbisë,

Kundër: F. K., ...,

Palë përgjegjëse në kërkesë,

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KPCC/D/A/204/2013, të datës 11 Qershor 2013 ,(lënda e regjistruar në AKP me numër KPA21102),pas shqyrtimit të mbajtur me datë 12 Shkurt 2020, merr;

AKTGJYKIM

Ankesa e paraqitur nga N. Dj., kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/204/2013, të datës 11 Qershor 2013, për sa i përket kërkesës, (të regjistruar në AKP me numrin KPA21102), hedhet poshtë si e pa lejuar.

Përmbledhje e çështjeve faktike dhe procedurale:

1. Me datë 18 Janar 2007, H. Dj., ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës me të cilën ka kërkuar ri-posedimin e pasurisë së paluajtshme e cila gjendet në vendin e quajtur, "... , ku sipas pretendimeve të tij ka pas oborr prej 3 ari dhe dy shtëpi përdhese, njëra 40 m², kurse tjetra rreth 30 m².
2. Ai deklaron se shtëpitë janë djegur por kërkon kthimin e posedimit të ngastrës, duke pohuar se humbja e posedimit lidhet me konfliktin e armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë më 1998/99, e cek datën 18 qershor 1999, si datë të humbjes së posedimit të pronës.
3. Në mbështetje të kërkesës së tij, pala ankuese i ka dorëzuar AKP-së, dokumentet në vijim:
 - Kopje të Skicës të vizatuar me laps.
 - Kopjen e letërnjoftimit lëshuar nga Komuna e Obiliqit, me 3 Tetor 1990, që dëshmon se adresa e tij e banimit ka qenë, ..., Nr. 66.
4. Ekipi i njoftimit i AKP-së ka bërë përpjekje që të bëjë identifikimin e pronës më 23 maj 2008 dhe 03 Qershor 2011. Sipas raportit të njoftimit, prona e kërkuar është gjetur të jetë shtëpi e ndërtuar rishtas në shfrytëzim të F.K.,(tutje; pala përgjegjëse në ankesë), i cili ka nënshkruar

njoftimin për pjesëmarrje në procedurë në AKP, duke pretenduar të drejtë mbi pronën e kërkuar.

5. Në mbështetje të kërkesës së tij ai ka paraqitur; Kontratë joformale të shitblerjes të nënshkruar vetëm nga blerësi, por jo edhe shitësi Xh. Xh.(i afërm i paraqitësit të kërkesës), në praninë e dy dëshmitarëve e lidhur me 13 Prill 2010, me të cilën pala përgjegjëse në ankesë e blen ngastrën ..., me sipërfaqe prej 0.03.25ha.,e regjistruar në Fl. Poseduese nr. ..., Zona Kadastrale Obilic, dhe se paguhet çmimi blerës, duke e pohuar faktin se prona evidentohet në emër të pronarit të mëparshëm Ž. S.
6. Sipas raportit të verifikimit të Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së, të datës 16 Nëntor 2011 nuk është gjetur as një evidencë që dëshmon se paraqitësi i kërkesës të evidentohen si pronar i pronës së kërkuar. Certifikata e pronësisë dëshmon se prona evidentohet në emër të Ž. (S.), S.
7. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, e ka kontaktuar paraqitësin e kërkesës, nga ai ka kërkuar të paraqesë dokumente plotësuese për të vërtetuar të drejtën e pretenduar pronësore mbi pronën e kërkuar, pasi që dokumentet e dorëzuara tashmë nuk e vërtetojnë mjaftueshëm këtë rrethanë, gjer sa *ex officio*, në organet kompetente dhe kadaster me datë 25.02.2010, nuk ishte gjetur asnjë pronë e regjistruar në emër të palës kërkuese dhe as ndonjë faturë për të dëshmuar pagesën e komunalive në emër të tij.
8. Për më tepër, palës ankuese i është dërguar njoftimi zyrtar me të cilin njoftohet se, nëse nuk i paraqet dokumentet e kërkuara brenda afatit të caktuar, kërkesa e tij mund të refuzohet nga Komisioni.
9. Pala ankuese nuk i ka paraqitur dokumentet e kërkuara.
10. Me vendimin numër KPCC/D/A/204/2013, të datës 11 Qershor 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme “KKPK”),e ka refuzuar kërkesën e tij, me arsyetim se paraqitësi i kërkesës nuk e ka vërtetuar pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër mbi pronën e kërkuar menjëherë para apo gjatë konfliktit të viteve 1998-1999.
11. Në versionin e vendimit individual në gjuhën serbe ka një mospërputhje gjuhësore ku thuhet se “kërkesa hidhet”, ndërsa në versionin në gjuhë shqipe dhe gjuhë angleze shkruhet se, ”kërkesa refuzohet”, që është versioni i saktë.
12. Më 4 Nëntor 2015, vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese. Më 8 Dhjetor 2015 N. D. (sipas pohimit vëlla i paraqitësit të kërkesës, tani e tutje si “pala ankuese”), ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-ës në interes të vëllait të tij.

13. Me 11 Prill 2017 një kopje e ankesës i është dorëzuar palës përgjegjëse, i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë, në afatin kohor të paraparë me ligj.

Pretendimet e palës ankuese;

14. Pala ankuese nuk ka shkruar ankesë formale në kuptim të nenit 178 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 38/2008), (më tej LPK), por ka paraqitur në emër të vëllait një mori dokumentesh me qëllim të dëshmisë se prona i takon të vëllait. Nuk ka specifikuar as për çfarë arsyes e atakon Vendimin, në cilat pjesë shfaqe mospajtim. Po ashtu ai nuk paraqet një autorizim valid të dhënë nga paraqitësi i kërkesës në AKP.

Pranueshmëria e Ankesës;

15. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe dokumenteve të paraqitura nga pala ankuese, sipas nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008), gjykata duke u ndërlidhur me shqyrtimin e aktgjykimit sipas detyrës zyrtare dhe për shkaqet e cekura dhe jo të cekura në ankesë gjeti se ankesa është e palejueshme dhe e paraqitur jashtë afatit të paraparë me ligj.

16. Ankesa është e palejueshme, sepse e ka paraqitur personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj ashtu siq parashihet në nenin 186.3, të LPK-së. Më saktësisht edhe neni 5.2 i Urdhëresës Administrative 2007/5, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, “Mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale” (në tekstin e mëtejme “Ligjin nr. 03/L-079”), parasheh: *“Në procedurën para Komisionit, në rast se personi fizik nuk është në gjendje të bëjë kërkesë, kërkesa mund të bëhet nga anëtari i familjes së ngushtë të atij personi. Paraqitësi i kërkesës mund të përfaqësohet nga një person fizik i autorizuar me autorizim të vlefshëm dhe të zbatuar si dubet.*

Arsyetimi ligjor ;

17. Sipas nenit 1 të së njëjtës Urdhëresës Administrative 2007/5, të ndryshuar me Ligjin, nr. 03/L-079, *“Anëtar i familjes së ngushtë” janë, bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë bashkësisë martesore apo të adoptuar) dhe personat e tjerë të cilët bartësi i të drejtës së pronës është i obliguar t’i mbajnë në pajtueshmëri me ligjin në fuqi, apo personat që janë të obliguar ta mbajnë bartësin e së drejtës së pronës në pajtueshmëri me ligjin në fuqi, pa marrë parasysh nëse personi ka banuar apo nuk ka banuar në pronë së bashku me bartësin e së drejtës së pronës”.*

18. Siç rezulton nga dispozita e lartë cekur vëllau nuk konsiderohet si anëtar i ngusht i familjes dhe ashtu si u theksua më lartë pala ankuese nuk ka një autorizim valid. Për këtë arsye ne mungesë të një autorizimi valid ai nuk ka legjitimitet të përfaqësimit.

19. Përveç kësaj Ankesa është e pas afatshme. Neni 12.1i ligjit nr. nr. 03/L-079”, përcakton si në vijim: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqes ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”*
20. Pala kërkuese e ka pranuar vendimin e KKPK-së më 4 Nëntor 2015,që konfirmohet me nënshkrimin e tij, sipas këtij fakti afati dëshmohej se afati për të paraqitur ankesë ka skaduar ditën e 30-të, me datë 3 Nëntor 2015, pasi që dita e 30-të ka qenë ditë pune. Megjithatë, pala ankuese ka paraqitur ankesë, më 8 Dhjetor, 4 ditë pas skadimit të afatit ligjor. Nga gjendja e këtyllë vërtetohet se, ankesa është paraqitur edhe jashtë afatit të përcaktuar me ligj.
21. Gjykata ka gjetur se dorëzimi është bërë personalisht në përputhje me nenin 110.1, të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 38/2008). Pala ankuese nuk ka paraqitur asnjë arsye për vonesën në paraqitjen e ankesës, dhe as gjykata në shkresat e lëndës nuk ka gjetur prova që do të justifikonin vonesën eventuale.
22. Prandaj, ankesa hedhet poshtë si e papranueshme në bazë të arsyeve procedurale të ligjit të lartpërmendur. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme nuk ka mundur t'i shqyrtoj meritat e ankesës.
23. Gjykata gjatë shqyrtimit të kësaj lënde edhe *ex officio* gjen se, Vendimi individual në gjuhën serbe, që i referohej kërkesës me numër KPA21102, KPCC/D/A/204/2013, i datës 11 Qershor 2013, ishte i përfshirë me gabim gjuhësor por që ky gabim nuk ndikon në përmbajtjen e çështjes së vendosur. Në vendimin individual në gjuhën serbe thuhet se, *“kërkesa hedhet”*, kurse në vendimin grupor në të tria gjuhët zyrtare në përdorim dhe në vendimin individual në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze thuhet se, *“kërkesa refuzohet”*.
24. Sipas dispozitave material përcaktohet se, në rast mospajtimi apo ndryshimi në mes të versionit në gjuhë angleze dhe versionit në gjuhët e tjera, versioni në gjuhë angleze mbizotëron, bazuar në nenin 3.3, të Urdhërësës Administrative nr. 2007/5, për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe ato komerciale, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ku parashihet se, *“Kurdo që paraqitet ndonjë dallim apo papajtueshmëri në lidhje me ndonjë fjalë, frazë apo interpretim ndërmjet versionit në gjuhën angleze të dokumentit apo vendimit karshi versionit në gjuhën shqipe apo serbe, fjala, fraza apo interpretimi në gjuhën angleze do të mbizotërojë dhe do të përdoret”*.
25. Prandaj me që vendimi burimor grupor në të tria gjuhët, dhe ai individual në gjuhë burimore angleze dhe gjuhë shqipe, figuron se *“refuzohet kërkesa”*, nuk është me ndikim gabimi gjuhësor në vendimin individual në gjuhë serbe, sepse duhet të jetë kërkesa refuzohet , e jo kërkesa hedhet, sepse interpretimi dhe versioni në gjuhë angleze mbizotëron si origjiner dhe si i tillë përdoret.

26. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese apo palëve me interes ligjor, për të kërkuar të drejtën e tyre pronësore, para gjykatës apo organit kompetent, nëse e vlerësojnë me interes legjitim.
27. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në përputhje me nenin 13.3.(b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195, paragrafin 1(a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

28. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
GSKKPA-A-075-2016, me datë, 12 Shkurt 2020

Bashkp. Profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani